

VENDIM
Nr.136, datë 18.12.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“TERMOCENTRALI Vlorë” SHA PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “a” dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe vendimit nr.135, datë 18.12.2008 “Për një devijim nga neni 18 i rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, në lidhje me fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Termocentrali Vlorë” sh.a., Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Termocentrali Vlorë” sh.a. dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Termocentrali Vlorë” sh.a., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria “Termocentrali Vlorë” sh.a., të plotësojë dokumentacionin e munguar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta